



qendra e provimeve

**MASA**  
E VËRTETË  
E NJOHURIVE

# GARAT SHTETËRORE 2022

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE, KLASA VI

# MATEMATIKË

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrolloi

Podgoricë, ..... 20.....



## UDHËZIM PËR PUNË

Të dashura nxënëse dhe nxënës,

Urime! Keni arritur që të vini në garat shtetërore nga matematika dhe me këtë hap keni arrite një sukses të madh. Prandaj detyrat që janë para jush shikoni si një problem interesant dhe përpiquni që t'i zgjidhni me një kujdes dhe angazhim të plotë, por edhe me një kënaqësi.

Renditja e zhvillimit të detyrave nuk është e rëndësishme. Nëse ndonjë detyrë ju duket shumë e vështirë, mos u ndalni shumë në të, por kaloni në detyrën tjetër. Nëse ju mbetet kohë, kthehuni dhe provoni t'i zgjidhni përsëri ato detyra të cilat nuk i keni zgjidhur.

*Shkruani lexueshëm, posaçërisht numrat!*

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk lejohet asnjë lloj bashkëbisedimi.

Gjatë punës mund të përdorni lapsin kimik dhe veglat shkollore për vizatimin e figurave gjeometrike, por nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë, kalkulatorëve dhe mjeteve tjera ndihmëse elektronike.


Për çdo detyrë janë paraparë nga 25 pikë.

*Për punë keni 180 minuta.*

Mund të filloni nga puna.

*Me fat!*

1. Parcela në formë të drejtkëndëshit përbëhet nga 5 parcela në formë të katrorit, pronarë të cilave janë Migjeni, Artani, Selvia, Hëna dhe Roni (shiko figurën). Parcela e Hënës dhe Ronit janë të madhësisë së njëjtë. Të gjithë ata duan të kositin parcelat e veta dhe për atë punë kanë angazhuar Sokolin. Sokoli ka çmim standard për njësi të sipërfaqes, por Roni i ka kërkuar dy herë më shumë të holla për njësi të sipërfaqes për shkak të terrenit të pjerrët dhe sasisë së madhe të gurëve në parcelën e tij. Nëse dihet se Roni për kositje ka paguar 60 euro, përcaktoni harxhimet e kositjes për secilin pronar të parcelës.



2. Një numër katër shifror është 102 herë më i madh se shuma e shifrave të tij. Vërtetoni se ai numër është i pjesëtueshëm me 9, e pastaj përcaktoni atë numër.

3. Alketa ka menduar një numër tre shifror pastaj ia ka shtuar shumën e numrave y dhe z. Numrin y e ka fituar ashtu që numrit x ia ka fshirë shifrën e qindësheve, ndërsa numrin z ashtu që numrit y ia ka fshirë shifrën e dhjetëshve. Si rezultat ka fituar një numër katër shifror shkrimi i të cilit përfundon me 24. Cilin numër e ka menduar Alketa?

4. Nderimi ka një tufë letrash për lojë në të cilën gjenden vetëm mbretër, mbretëresha, ase dhe xhandarë. Momentalisht është vetëm në klasë dhe ka filluar të vendosë letrat në rend, njërin pranë tjetrit, me fytyrë të kthyer poshtë kah tavolina. Së pari ka vendosur të gjithë xhandarët. Pastaj në fillim dhe në fund të rendit dhe në mes të çdo dy xhandarëve ka vendosur nga një mbretëreshë. Më pas ndërmjet çdo dy letrave ka vendosur nga një mbret. Më në fund, në mes të çdo mbretit dhe mbretëreshës ka vendosur nga një as. Në atë moment janë vendosur 241 letra për lojë dhe në klasë hyn shoku i Nderimit, Majlindi. Majlindi do të dijë sa ka mbretër në letrat e vendosura në tavolinë dhe të dijë se cili tip i letrës gjendet në pozitën e 90-të (nga e majta në të djathtë). Detyra jote është që, duke shfrytëzuar të dhënat, t'i ndihmosh Majlindit të gjejë përgjigjet në pyetjet e tija.























